



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.108/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Hajriz Hoti dhe Violeta Husaj Rugova - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, të parashtruar kundër subjektit politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 08.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa e subjektit politik, Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, ZL.Anr.108/2025, e datës 05.10.2025, paraqitur kundër subjektit politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.108/2025, nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak me seli në Mitrovicë të Veriut, me të cilën pretendon se duke ndjekur rrjetet sociale, aktivistët e SPO vunë re se në profilin në Instagram të Srpske Demokratije, Vladimir Radosavljević (i padituri), kandidat për kryetar komune të Leposaviqit, transmetoi një video/bisedë lidhur me blerjen e votave nga ana e Srpska Lista, në të cilën duket se po shpërndahen pako gjatë fushatës para-zgjedhore dhe po shkelet vullneti i votuesve në komunën e Leposaviqit, ku në fund të videos subjekti që mori pakën/mitën konfirmoi në pyetjen "a duhet të votohet për srpska lista" përgjigja ishte "duhet". Gjithashtu, gjatë videos i padituri tha: "po i blejmë votat si në Somali, hajde Rasić që po blen, por edhe ju falas". Këto deklarata janë të pavërteta, dhe të pasakta dhe publikimi është bërë pa kontrolluar saktësinë, pa u siguruar që deklaratat janë të sakta, me çka është shkelur ligji 02/L-65, neni 5, paragrafët 5.1, 5.2 dhe 5.3 për përgjegjësinë për shpifje dhe fyerje. Ky publikim ka shkaktuar dëm në formën e dëmtimit të reputacionit, nderit, dinjitetit të paditësit, mundësinë e humbjes

së besimit të publikut, si dhe dëm profesional. Kërkojnë që PZAP-i të miratojë ankesën si të bazuar dhe ndëshkohet subjekti politik Srpska Demokratija - Aleksandar Arsenijević në përputhje me normat dhe rregullat ligjore lidhur me fushatën zgjedhore.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Srpska demokratija i refuzon pohimet nga ankesa e Nenad Rašić-it si të pabazuara, të pasakta dhe të paqëndrueshme nga ana ligjore. Publikimet në rrjetet sociale që përmenden në ankesë përfaqësojnë koment politik dhe reagim brenda debatit para-zgjedhor dhe bazohen në rastin nga shkurti 2025 kur Srpska Demokratija dëshmoi blerjen e votave në ambientet e partisë SPO në Leposaviq, dhe jo në një "fushatë shpifjesh" siç e pretendon ankesuesi. Gjithashtu, PZAP nuk ka kompetencë të vendosë për çështje shpifjeje, pasi kompetenca e saj është e kufizuar qartë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në përgjigje në ankesë theksohet se argumenti kyç – shkelje e dëshmuar e ligjit më 02 shkurt 2025 ku me datë 02 shkurt 2025, subjekti politik Srpska Demokratija publikoi videot në të cilat shihet dhe dëgjohet qartë blerja e votave nga partia e Nenad Rašić-it (SPO). Në materialin e diskutuar përmenden në mënyrë eksplicite emri i partisë, dhe emri i Nenad Rašić-it, dhe votuesve u ofrohen pajisje elektroshtëpiake, mobilje dhe pako ushqimore. Për këtë arsye, deklarata e Vladimir Radosavljević-it që është objekt e ankesës përfaqëson koment politik të bazuar në fakte dhe dëshmi të përdorshme publike, si dhe në rastin e blerjes së votave nga shkurti 2025, të cilin Vladimir Radosavljević personalisht e zbuloi dhe dokumentoi, dhe jo shpifje dhe as fyerje. Si dëshmi ka bashkangjitur CD me video incizime.

Paneli, pasi që shqyrtoj te gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se :

-Ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, të parashtruar kundër, subjektit politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicë të Veriut, është parashtruar pas afatit ligjor të rregulluar me nenin 39 paragrafi 3 i Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe në nenin 13, par. 3, nën par. 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit, dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.*

Në nenin 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se : *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara, ndërsa nën par. 5.5 parasheh*

që: “për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”.

Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga ankuesi nuk është specifikuar data e publikimit të shkeljes së pretenduar në rrjetin social instagram të subjektit politik Srpska Demokratija dhe meqenëse nuk është dëshmuar nga ankuesi data e publikimit të fotos, Paneli, mori veprime hetimore konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, në të cilin nen thuhet se “Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.” Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pasafatshme, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social instagram të Subjektit Politik Srpska Demokratija shihet se publikimet e bëra në instagram janë bërë me datë 30 Shtator 2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh. Pra, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 39, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Në rastin konkret pala ankuese ankesën e ka dorëzuar në PZAP me datë 05.10.2025, pra 5 ditë më vonë nga shkelja për të cilën pretendon pala në ankesën e tij, e që nënkupton se ankesa në fjalë është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor, dhe duke u bazuar në nenin 39, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe nenet 9 paragrafi 5 dhe 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.108/2025 datë 08.10.2025

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.